



Co-funded by
the European
Union



Kryqi Kuq Shqiptar
Rruga Pjeter Budi,
Ndërtesa 19,
Tiranë

FTESË PËR TENDER

1. FORCIMI I REZILIENCËS TE TË MOSHUARIT DHE PERSONAT ME AFTËSI NDRYSHJE GJATË COVID-19 DHE KATASTROFAVE TË ARDHSHME

A. PËRSHKRIMI I PËRGJITHSHËM

Projekti “Forcimi i reziliencës te të moshuarit dhe personat me aftësi ndryshe gjatë COVID-19 dhe katastrofave të ardhshme” është një iniciativë trevjeçare në rajonin e Ballkanit Perëndimor, e koordinuar nga Kryqi i Kuq i Serbisë dhe i mbështetur nga Bashkimi Evropian, Agjencia Austriake për Zhvillim dhe Kryqi i Kuq Austriak. Filluar në fund të vitit 2020, ai lidh partnerët e shoqërisë civile nga Serbia, Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Mali i Zi, Maqedonia e Veriut dhe Kosova* dhe rrjete të mëdha të shoqërisë civile që përfaqësojnë personat e moshuar dhe personat me aftësi ndryshe në nivel të Bashkimit Evropian.

Objektivi i përgjithshëm i projektit është të kontribuojë në forcimin e reziliencës së të moshuarve dhe personave me aftësi ndryshe në Ballkanin Perëndimor gjatë Covid-19 dhe katastrofave të ardhshme.

Objektivi specifik: Personat e moshuar, personat me aftësi ndryshe, OJF-të dhe organizatat lokale janë më të afta për të përballuar situatën e Covid-19 në Shqipëri, Bosnjë dhe Hercegovinë, Maqedoninë e Veriut, Malin e Zi, Serbinë dhe Kosovën.

B. PSE ËSHTË PARASHIKUAR KJO MBËSHTETJE FINANCIARE PËR PALË TË TRETA


Ky aktivitet do të mund tu demonstrojë anëtarëve të komunitetit, vendimmarrësve dhe shoqërisë civile se mobilizimi dhe aktivizmi i përshtatur sipas kontekstit në nivel lokal mund të jetë efektiv për rritjen e përfshirjes së të moshuarve dhe personave me aftësi ndryshe dhe pjesëmarrjen e tyre në komunitet, duke përfshirë zhvillimin e politikave publike.

Ofrimi i mbështetjes dhe aktiviteteve që rrisin përfshirjen sociale dhe pjesëmarrjen e të moshuarve dhe personave me aftësi ndryshe në kontekstin lokal do të paraqiten si modele që vendimmarrësit në nivel lokal mund të marrin në konsideratë për mbështetjen e ardhshme.





Co-funded by
the European
Union



2. FTESA PËR TENDER


Në kuadër të projektit ‘‘Forcimi i reziliencës të të moshuarit dhe personat me aftësi ndryshe gjatë COVID-19 dhe katastrofave të ardhshme’’, jeni të ftuar për paraqitjen e ofertave më të mira për një apo disa nga aktivitetet e mëposhtme:

- Nisma për zhvillim dhe advokaci të politikave lokale.
- Ofrimi i shërbimeve me shtrirje të vogël, me bazë vullnetare për personat e moshuar dhe personat me aftësi ndryshe që fillimisht mund të testohen dhe më pas të advokohen si shërbime të qëndrueshme (p.sh. ofrimi i shërbimeve në zona të largëta dhe rurale, të vështira për t'u arritur).
- Përgatitja e materialeve për dialog për politika lokale dhe kombëtare, ndërgjegjësimin e publikut dhe edukim.
- Veprimtari ndërgjegjëse dhe edukuese mbi tema të përfshirjes sociale të të moshuarve dhe personave me aftësi ndryshe, moshimi aktiv, vullnetarizmi.
- Nisma për edukim jo-formal/të mësuarit gjatë gjithë jetës në komunitetet lokale
- Aktivitete kulturore me pjesëmarrjen e të moshuarve dhe personave me aftësi ndryshe
- Përshtatja e mjediseve sociale dhe komunitare të cilat nuk janë të aksesueshme për personat me aftësi ndryshe për të mbështetur përfshirjen e tyre në nivel komuniteti

Projekte që nuk përfshihen në listën e mësipërme, por që gjithësesi dukshëm synojnë të kontribuojnë në përfshirjen sociale të të moshuarve apo personave me aftësi ndryshe mund të propozohen.


Shembull:

1. Tema e aktivitetit	Seminare edukative për të moshuarit/personat me aftësi ndryshe
2. Periudha e zbatimit	Tetor 2022- Korrik 2023
3. Përshkrimi i aktivitetit	Psh. Organizimi i seminareve sistematike për të moshuarit/personat me aftësi ndryshe lidhur me një sërë çështjesh që lehtësojnë pjesëmarrjen sociale. Seminarët do të përdorin përvojën e profesionistëve të fushave të ndryshme për të mësuar aftësi të ndryshme (si të shkruajmë në mënyrë kreative, pikturojmë, punojmë me argjile, të gatujmë etj), si dhe të moshuar/persona me aftësi ndryshe që janë trajnuar në një nga fushat e mësipërme. Njohuritë e përfutuara nga seminarët do të mund të përdoret për të filluar aktivitete të vogla fitimprurëse ose jo fitimprurëse, në të cilat të moshuarit/personat me aftësi ndryshe organizojnë ekspozita etj ku paraqesin apo shesin punët e tyre.
4. Rezultatet për t'u arritur	Psh. Të moshuarit mësojnë njohuri dhe aftësi të reja dhe janë më aktivë dhe marrin pjesë në jetën sociale të komunitetit
5. Maksimumi i buxhetit	5700 Euro për aplikant





Co-funded by
the European
Union



3. Aplikantët e lejuar

Organizatata Jo-Fitimprurëse (OJF), anëtarë të rrjeteve të shoqatave që janë aktive në nivel lokal e që punojnë me traget grupet e projektit që janë të moshuarit dhe personat me aftësi ndryshe.

Të gjitha projekte apo aktivitetet e propozuara do të zbatohen në territorin e Republikës së Shqipërisë

4. Si aplikohet

Ju lutemi plotësoni **Formularin e Aplikimit** duke përfshirë një përshkrim të detajuar se si ju mendoni ta zbatoni projektin apo aktivitetin, buxhetin përkatës si dhe një plan pune të detajuar.

Dokumente të tjera të detyrueshme për të dorëzuar në tender:

(nëse këto dokumente nuk dorëzohen kërkesa juaj do të refuzohet, dhe projekt propozimi nuk do të shqyrtohet nga ana përmbajtësore nga komisioni i vlerësimit.)

- **Dokumenta që çertifikojnë statusin ligjor të aplikantit:**
 - Statuti, Akti i Themelit
 - Ekstrakti i Gjykatës (i cili merret në Zyrën e Regjistrimit të OJF-ve, pranë Gjykatës së Rrethit
 - Tiranë) - origjinal brenda 3-mujorit referuar datës së mbylljes së afatit të aplikimit;
 - Vërtetim që organizata është me status aktiv në momentin e aplikimit;
 - Vërtetim nga Drejtoria e Tatimeve që ska detyrime të pashlyera.
 - CV e Organizatës (të firmosur dhe vulosur nga përfaqësuesi ligjor i OJF-së). CV duhet të përmbajë informacion për projektet e zbatuara së bashku me buxhetin e tyre, donatorët përkatës, partnerët etj.
- **Dokumenta që çertifikojnë kapacitetin financiar të aplikantit:**
 - Pasqyrat financiare të organizatës në dy vitet e fundit
 - Vërtetim i llogarisë bankare: konfirmim se llogaria e shoqatës nuk është bllokuar në 24 muajt e fundit.


Afati për aplikim:

Të gjithë dokumentet si më sipër duhet të dorëzohen brenda datës 15 shtator 2022, ora 15:00 në adresën e-mail: aplikimpergrante@kksh.org.al dhe në subjekt të email-it të specifikohet “Projekt propozime për grante te vogla” ose të dorëzohen dorazi në adresën e Kryqit të Kuq Shqiptar, Rruga Pjeter Budi, Ndërtesa 19, Tiranë, brenda datës 15 shtator 2022, ora 15:00.

5. Termat dhe kushtet e ftesës për tender

- a. Gjuha e aplikimit- i gjithë dokumentacion duhet të jetë në gjuhën shqipe. Zarf i aplikimit duhet të jetë i mbyllur/vulosur dhe të përmbajë emrin dhe adresën e shoqatës aplikuese, emrin e projektit për të cilin po aplikohet – *Forcimi i reziliencës te të moshuarit dhe personat me aftësi ndryshe gjatë COVID-19 dhe katastrofave të ardhshme.*

Të gjitha aplikimet e dërguara si ato në formë elektronike ashtu edhe ato dorazi do të hapen nga Komisioni i Vlerësimit, menjëherë pas përfundimit të afatit të dorëzimit që është data 15 shtator 2022, ora 15:00





Co-funded by
the European
Union



b. Çmimet dhe TVSH

Të gjitha çmimet duhen në monedhën kombëtare (Lekë) si dhe në EURO, pa përfshirë tatimin mbi vlerën e shtuar (TVSH), e cila nuk mbështetet nga fondi i alokuar, përveçse kur ju mund të provoni se nuk mund të rimbursoheni për TVSH dhe për çdo shpenzim në projekt, kontraktori do të kërkohet të sigurojë konfirmim të përjashtimit nga TVSH prej autoriteteve përkatëse.

c. Grafiku kohor

Për sqarime të mëtejshme dërgoni një email jo më vonë se: Në adresën elektronike:	9 shtator, 2022 tracing@kksh.org.al
Oferta juaj duhet të dorëzohet jo më vonë se: Dhe duhet dërguar në adresën :	15 shtator 2022, ora 15:00 aplikimpergrante@kksh.org.al
Data e hapjes së tenderimit:	15 shtator 2022, ora 15:00
Data e lajmërimit për fituesit:	30 shtator 2022
Data e firmosjes së kontratës me fituesit:	3 tetor 2022

6. Kriteret për aplikim të suksesshëm

Kontrata do ti jepet ofertave në përputhje me principin e ofertës më të mirë (raporti më i mirë çmim-cilësi) dhe kriterëve të vlerësimit të vendosur më poshtë.

- Dorëzimi i aplikimit në afat
- Buxheti brenda kufijve të kërkuar
- Aktivitetet janë formular qartë dhe lidhen me rezultatet e kërkuara të projektit të përshkruara më lart.
- Shoqata aplikuese është e lidhur mirë me aktorët relevantë për iniciativën e propozuar
- Shoqata aplikuese në kushte ideale ofron disa burime si infrastrukturë, pajisje, nurime njerëzore etj
- Shoqata aplikuese ka kapacitete për të zbatuar aktivitetet dhe për të dorëzuar raportet narrative dhe financiare.
- Shoqata aplikuese duhet të sigurojë transparencë dhe besueshmëri.
- Vetëm aplikimet që përdorin këtë format do të pranohen.
- Kontrata do t'i jepet ofertave me raportin më të mirë çmim-cilësi për aktivitetet e propozuara.

7. Aneks

- Formati i aplikimit- Aneksi A
- Formati i Buxhetit- Aneksi B





Co-funded by
the European
Union




Aneksi A

FORCIMI I REZILIENCËS TE TË MOSHUARIT DHE PERSONAT ME AFTËSI NDRYSHE GJATË COVID-19 DHE KATASTROFAVE TË ARDHSHME

FORMULAR APLIKIMI PËR MINI-PROJEKTE

1	<i>Emri i organizatës</i>	
2	<i>Emri i personit përfaqësues:</i>	
3	<i>Tel:</i>	
4	<i>Fax:</i>	
5	<i>E-mail:</i>	
6	<i>Adresa:</i>	
7	<i>Zona ku do të zbatohet projekti (adresa e vendit ku do të zbatohet):</i>	
8	<i>Buxheti i mini-projektit:</i>	




NACIONALNA ORGANIZACIJA
OSOBA SA INVALIDITETOM SRBIJE



H
A
J
D
E
Udruženje za pomoć i razvoj
Association for Help and Development



Co-funded by
the European
Union



Ju lutem plotësoni rubrikat e mëposhtme:

1. Cilat janë nevojat e target grupit? Si do i adresoni ju këto nevoja?

Specifikoni procesin se si janë siguruar të dhënat mbi nevojat.

2. Synimi i mini-projektit

Specifikoni se cilës sfidë kryesore do t'i japë përgjigje ky miniprojekt.

Për shembull:

- Të moshuarit dhe personat me aftësi ndryshe kanë mundësi të levizin më lirisht në komunitet, të kryejnë takimet që i duhen dhe duan (psh takime me mjekun, takime me miqtë etj)
- Një model efektiv dhe i qëndrueshëm për transferimin e njohurive dhe aftësive që do të ndihmojnë në afrimin më të madh të brezit të ri me atë më të vjetër, do të lehtësojë të kuptuarit mes tyre dhe formimin e lidhjeve mes brezave, çka mund të përsëritet në zona të tjera.

3. Kush do ta zbatojë miniprojektin?

Specifikoni numrin e pjesëmarrësve në projekt.

Specifikoni emrin e personit që drejton grupin dhe merr përgjegjësi për gjithë zbatimin e miniprojektit.

4. Si do të angazhohet popullata e targetuar në zbatimin e projektit?

Përshkruani rolin që të moshuarit apo personat me aftësi ndryshe në komunitetin tuaj do të luajnë në miniprojekt, sa prej tyre do të përfshini dhe si planifikoni ta inkurajoni pjesëmarrjen e tyre.

5. Grupi target

Specifikoni cilat nëngrupe të popullatës së të moshuarve dhe personave me aftësi ndryshe në komunitetin tuaj do të targetojnë aktivitetet e miniprojektit:

Persona me vështirësi lëvizëse, të moshuar të vetmuar, gra që kanë humbur dëgjimin, gra të moshuara, familje me persona me aftësi ndryshe, kujdestarë informalë për të moshuarit ose personat me aftësi ndryshe etj.

Për shembull:

Të moshuar të vetmuar, familje me familjarë të moshuar ose persona me aftësi ndryshe që kujdesen për bashkëshortët e tyre, kujdestarë informalë.



NACIONALNA ORGANIZACIJA
OSOBA SA INVALIDITETOM SRBIJE



H
A
J
D
E
Udruženje za
pomoć i
razvoj
Association
for Help and
Development



Co-funded by
the European
Union



6. Rezultatet e pritshme të miniprojektit

Specifikoni ju lutem rezultatet e aktiviteteve të planifikuara, përfshi eventet publike.

Specifikoni gjithashtu numrin e saktë dhe burimet e verifikimit që mund të përdoren për vlerësim kur të jetë e nevojshme.

Miniprojekti mund të ketë disa rezultate të pritshme

Për shembull:

- 50 të moshuar përdorin më shpesh teknologjinë e informacionit për t'u informuar mbi shërbimet dhe mundësitë e tjera të pjesëmarrjes në shoqëri. Shërbimet dixhitale janë më të përdoshme nga të moshuarit.
- 20 persona me aftësi ndryshe përvetësojnë aftësi e njohuri të reja si dhe janë më aktivë e përfshihen rregullisht në jetën sociale.

7. Aktivitetet dhe eventet

Listoni gjithë aktivitetet në projekt si dhe eventet që do të organizohen (përfshi numrin e pjesëmarrësve dhe detaje të tjera)

Për shembull:

- Tavolinë e rumbullakët me aktorët lokalë të komunitetit.
- Seminare të rregullta ndërbreznore për transferimin e njohurive dhe të aftësive me të moshuar, persona me aftësi ndryshe dhe nxënës apo student.

8. Kohëzgjatja e advokacisë së miniprojektit

Specifikoni ju lutem afatet e parashikuara për aktivitetet

Mbani parasysh se këto afate duhet të parashikojnë si kohën për përgatitje ashtu edhe për raportim.

Muaji	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10
Aktiviteti 1										
Aktiviteti 2										
Aktiviteti 3										
Aktiviteti 4										
Aktiviteti 5										
Aktiviteti 6										
Aktiviteti 7										
Aktiviteti 8										
Aktiviteti 9										





Co-funded by
the European
Union



ANEKSI B

9. Buxheti

a) Shpenzimet e parashikuara

Kontribut për pagesën e koordinatorit të mniprojektit

Tarifë (fee) për bashkëpunëtorët

Kosto karburanti, (0.10 Euro për kilometër)

Kancelari

Komunikim (Telefoni, internet, posta)

Pergatitje materialesh informative për fushatë

Printim fotokopjim

Qera salle për takime, panele diskutimi etj

Refreshments (Kafe, pije) për takime, panele diskutimi etj

Pagesa per dizenjimin dhe prodhimin e materialeve ndërgjegjësuese (poster, fletëpalosje, bluza, stilolapsa etj)

Pagesa për prodhimin e materialeve ndërgjegjësuese (poster, fletëpalosje, bluza, stilolapsa etj)

	Kategoria	Sasia	Vlera	Totali në Lekë	Totali në Euro
1	Burime Njerëzore				
	Pagesë për koordinatorin (maksimumi 50% e buxhetit)				
	Tarifë (fee) për bashkëpunëtorët				
2	Transporti				
	Karburant				
	Bileta autobuzi				
	Bileta treni				
3	Evente publike				
	Qera				
	Refreshment (Kafe, pije, etj)				
4	Materiale për fushatë				
	Dizenjim				
	Printim				
	Qera për hapsirë reklamuese				
5	Vizibilitet				
	Dizenjim				
	Prodhim				
6	Komunikim				
	Telefoni				
	Internet				
	Posta				
7	Kancelari				
8	Kosto zyre (maksimumi 2 % e buxhetit)				
Total					

Listoni edhe burimet tuaja që planifikoni të përdorni gjatë zbatimit të projektit (zyra, pajisje, mjete konsumi, burime njerëzore si dhe fonde nga burime të tjera).





Co-funded by
the European
Union



10. Partnerët

Specifikoni cila organizatë do tju mbështesë në zbatimin e miniprojektit (autoritete lokale, qendra shëndetësore, qendra sociale etj)

Data: _____

Organizata/Grupi komunitar
Drejtuesi

_____ Firma

_____ Emri




NACIONALNA ORGANIZACIJA
OSOBA SA INVALIDITETOM SRBIJE



HAJDE
Udruženje za pomoć i razvoj
Association for Help and Development



Co-funded by
the European
Union



Forcimi i reziliencës të të moshuarit dhe personat me aftësi ndryshe gjatë COVID-19 dhe katastrofave të ardhshme

Procedurat Standarde operacionale për mbështetjen financiare për palët e treta

1. Përkufizime

- **Partnerë** konsiderohen Kryqi i Kuq i Serbisë, Kryqi i Kuq Shqiptar, Shoqata Shqiptare e Gerontologjisë dhe Geriatriisë, Shoqata e Kryqit të Kuq të Bosnjës dhe Hercegovinës, Shoqata për Ndihmë dhe Zhvillim HAJDE, Kryqi i Kuq i Republikës së Maqedonisë së Veriut, Shoqata për mbështetje dhe zhvillim, Humanost, Organizata Kombëtare e Personave me Aftësi të Kufizuara të Serbisë, Karitas Kosovë, Kryqi i Kuq i Malit të Zi dhe Unioni i të Verbërve të Malit të Zi.
Partnerët janë Principalë për palët e treta.
- **Palët e treta** mund të jenë anëtarë të Organizatave të Shoqërisë Civile (OJF-të), anëtarë të rrjeteve ekzistuese të advokimit në vendet zbatuese ose organizata të tjera, grupe aktiviste dhe organizata lokale të regjistruara që punojnë me të moshuar.
Palët e treta janë Kontraktuesi i Partnerëve.

2. Prezantim

Ky dokument përcakton rregullat dhe procedurat për partnerët dhe përfituesit që kryejnë "mbështetje financiare për palët e treta" në kuadër të projektit të financuar nga BE "Forcimi i reziliencës të të moshuarit dhe personat me aftësi ndryshe gjatë COVID-19 dhe katastrofave të ardhshme". Ky akt parashikon ofrimin e mbështetjes financiare për shoqatat e shoqërisë civile vendase në gjashtë vendet ku zbatohet projekti. Shumica e tyre do të jenë anëtarë të rrjeteve ekzistuese të advokimit.


3. Objektivat dhe rezultatet

që do të përfitohen me mbështetjen financiare janë:

- OJF-të kryejnë aktivitete ndërgjegjësuere dhe të promovojnë përfshirjen sociale të personave të moshuar dhe personave me aftësi ndryshe
- OJF-të adresojnë mangësitë në ofrimin e shërbimeve në nivel lokal


4. Aktivitete të pranueshme janë parashikuar si më poshtë:

- Nisma për zhvillim dhe advokaci të politikave lokale.
- Ofrimi i shërbimeve me shtrirje të vogël, me bazë vullnetare për personat e moshuar dhe personat me aftësi të kufizuara që fillimisht mund të testohen dhe më pas të avokohen si shërbime të qëndrueshme (p.sh. ofrimi i shërbimeve në zona të largëta dhe rurale, të vështira për t'u arritur).
- Përgatitja e materialeve për dialog për politika lokale dhe kombëtare, ndërgjegjësimin e publikut dhe edukim.
- Veprimtari ndërgjegjësuere dhe edukuese mbi tema të përfshirjes sociale të të moshuarve dhe personave me aftësi ndryshe, moshimi aktiv, vullnetarizmi.
- Nisma për edukim jo-formal/të mësuarit gjatë gjithë jetës në komunitetet lokale
- Aktivitete kulturore me pjesëmarrjen e të moshuarve dhe personave me aftësi ndryshe
- Përshtatja e mjediseve sociale dhe komunitare të cilat nuk janë të aksesueshme për personat me aftësi ndryshe për të mbështetur përfshirjen e tyre





Co-funded by
the European
Union



në nivel komuniteti

5. Tipologjia e organizatave të shoqërisë civile që mund të marrin mbështetje financiare: Anëtarët e rrjeteve të OJF-ve dhe OJF-të që janë aktive në nivel lokal në vendet e synuara të projektit, si dhe iniciativat bazë.

6. Kriteret për përzgjedhjen e këtyre subjekteve dhe dhënien e mbështetjes financiare:

- Aktiviteti nuk e tejkalon shumën e përcaktuar të buxhetit
- Aktiviteti është brenda afatit kohor 10 mujor
- Aktiviteti kontribuon në arritjen e objektivit specifik të projektit dhe është në përputhje me qëllimin kryesor të projektit
- OJF-ja aplikuese është e koordinuar mirë me palët përkatëse të interesit për nismën përkatëse
- OJF-ja aplikuese idealisht ofron disa burime të veta, si infrastrukturë, pajisje, shpenzime, burime njerëzore dhe burime të tjera financimi
- OJF-ja aplikuese ka kapacitet për të zbatuar aktivitete dhe për të paraqitur raporte financiare dhe narrative (të vërtetohen në dosjen e aplikimit)
- Vetëm aplikimet e dorëzuara në formatin e dhënë do të konsiderohen për vlerësim
- OJF-ja aplikuese duhet të sigurojë transparencë dhe besueshmëri

7. Kriteret për përcaktimin e shumës së saktë të mbështetjes financiare:

- Shuma maksimale që mund të alokohet për aplikim është 5,700€, ndërsa shuma minimale është 2,000 €.
- Çdo aplikim duhet të përfshijë një buxhet të detajuar sipas të cilit do ti akordohet granti; në procedurën e përzgjedhjes një rëndësi e veçantë do t'i kushtohet efikasitetit të fondeve të buxhetuara. Kohëzgjatja e projekteve do të jetë dhjetë muaj.
- Nuk do të pranohen dhe mbështeten shpenzimet e mëposhtme si: blerja e pajisjeve të mëdha, ndërtimi dhe riparimi i objekteve
- Një OJF mund të paraqesë më shumë se një aplikim, por vetëm njëri prej tyre mund të financohet.

8. Procedurat Operacionale:

a) Të përgjithshme

Partnerët janë përgjegjës për palët e treta në vendet e tyre përkatëse të projektit. Aktivitetet dhe buxheti për palët e treta janë të specifikuar në seksionin 11 të këtij dokumenti.

b) Thirrje për tender

Bazuar në buxhetet përkatëse, Partnerët përgatisin Ftesën për Tender (Aneksi F) dhe formularin e Aplikimit (Aneksi A), duke ndjekur anekset e tjera bashkëngjitur

Tenderi do të publikohet në ëbsitin zyrtar të çdo organizate partnere dhe faqet e internetit të rrjeteve kombëtare të advokimit, si dhe në ëbsitin e projektit dhe faqen e projektit në Facebook, duke theksuar qartë afatin e aplikimeve. Për më tepër, informacioni mbi tenderin dhe ftesën për pjesëmarrje do të paraqitet në buletinet e nivelit kombëtar që do t'u dërgohen organizatave të shoqërisë civile në gjashtë vendet e projektit.

c) Paraqitja e aplikimeve

Organizatave kandidatë do të kenë kohë deri më 15 shtator 2022, ora 15:00 për të përgatitur dhe formularin e aplikimit. Formulari i aplikimit duhet të





Co-funded by
the European
Union



përfshijë një përshkrim të detajuar të veprimit të planifikuar, një buxhet, një plan pune të detajuar dhe një përshkrim të kapaciteteve për të zbatuar aktivitetin si dhe të burimeve të veta, si objektet, pajisjet, shpenzimet, burime njerëzore dhe burime të tjera financimi që mund të ofrojnë.

Për më tepër, aplikimit duhet t'i bashkëngjiten dokumentet e mëposhtme:

- Dokumenta që certifikojnë statusin ligjor të aplikantit:
 - Statuti dhe Akti i Themelit
 - Ekstrakti i Gjykatës (i cili merret në Zyrën e Regjistrimit të OJF-ve, pranë Gjykatës së Rrethit Tiranë) - original brenda 3-mujorit referuar datës së mbylljes së afatit të aplikimit;
 - Vërtetim që organizata është me status aktiv në momentin e aplikimit;
 - Vërtetim nga organet tatimore që organizata nuk ka detyrime të pashlyera
 - CV të Organizatës (të firmosur dhe vulosur nga përfaqësuesi ligjor i OJF-së). CV duhet të përmbajë informacion për projektet e zbatuara së bashku me buxhetin e tyre, donatorët përkatës, partnerët etj.
- Dokumenta që certifikojnë kapacitetin financiar të aplikantit :
 - Pasqyrat financiare të organizatës në dy vitet e fundit
 - Vërtetim i llogarisë bankare: konfirmim se llogaria e shoqatës nuk është bllokuar në 24 muajt e fundit.

c) Vlerësimi për aplikimet fituese

1. Pas marrjes së aplikimeve, komisioni i tenderit i krijuar nga Partneri i vlerëson ato duke ndjekur formularin e vlerësimit (Aneksi D) nga ku del me një listë të shkurtuar

2. Përzgjedhja përfundimtare do të bëhet nga komiteti i vlerësimit të projektit në secilën prej vendeve të projektit. Ky komitet do të përbëhet nga përfaqësuesit e partnerëve të projektit të secilit vend, përfaqësuesi i një institucioni publik përkatës si dhe përfaqësuesi i Delegacionit të BE-së nëse është e mundur. Koordinator i përgjithshëm i projektit do të ketë rolin mbikëqyrës dhe do të nënshkruajë përzgjedhjen përfundimtare pasi ta diskutojë atë me partnerët në secilën prej vendeve të projektit.

d) Procedura e dhënies së grant-it

Pas përfundimit të procesit të vlerësimit, Partneri informon aplikantët fitues për rezultatin me email. Kontrata duhet të nënshkruhet sipas modelit (Aneksi D) nga Partneri (si Lider) si dhe nga Kontraktori i përzgjedhur.

e) Zbatimi

Zbatimi i aktivitetit të mbështetur nga sub-granti do të realizohet nga kontraktori i përzgjedhur.


f) Monitorimi

Zbatimi i aktiviteve të zhvilluara nga Kontraktori duhet të monitorohet rregullisht nga Partneri.

g) Raportimi


Kontraktori

raporton tek Koordinator i përgjithshëm i Partnerit





Co-funded by
the European
Union



Raportimi financiar duhet të bëhet kundrejt buxhetit. Shpenzimet e kryera do të shoqërohen me dokumentet mbështetëse përkatëse siç specifikohet në kontratë.

Së bashku me raportin financiar nevojitet një raport narrativ që përshkruan aktivitetet kryesore, arritjet dhe sfidat e hasuar. Një model për raportin narrativ është dhënë (Shtojca E).


9. Dokumentet e nevojshme për raportim nga Partneri për Koordinatorin e Projektit, Kryqin e Kuq të Serbisë

- Përmbledhja e raportit narrativ të jetë në format tremujor, në anglisht si dhe një raport i plotë ku të përfshihet raporti vjetor dhe përfundimtar i projektit
- Kopje e raportit narrativ nga kontraktori
- Raportimi financiar të bëhet në kuadër të raportit financiar të projektit për Kryqin e Kuq të Serbisë duke raportuar shpenzimet faktike. Ky raport duhet të dërgohet kur të përfundojë i gjithë aktiviteti i sub-granteve
- Sigurimi i të gjitha dokumenteve financiare dhe mbështetëse (kopje të tyre) sipas kontratës me Kontraktorin: pasqyra bankare, fatura/kontrata, konfirmime të përjashtimit nga TVSH, me përshkrime të shkurtra në anglisht.
- Një kopje e kontratës e nënshkruar nga të dyja palët (Partneri dhe kontraktori)

10. Shembuj aktivitetesh të propozuara

1. Tema aktivitetit	Përfshirja dixhitale/ Trajnim mbi teknologjinë e informacionit për të moshuarit
2. Periudha e zbatimit	Tetor 2022-Korrik 2023
3. Përshkrimi i aktivitetit	P.sh. Organizimi i një sërë seminaresh trajnuese për të ndihmuar të moshuarit të kuptojnë dhe përdorin teknologjinë e informacionit që kanë në dispozicion. Aktivitetet do të koordinohen me shërbimet lokale publike dhe private, duke i inkurajuar ata që të bëjnë përmbajtjen e tyre dixhitale (faqet e administratës komunale, Qendra për Mirëqenie Sociale, Qendra Shëndetësore, shërbimet e ofrimit të kujdesit, mediat lokale) më të aksesueshme për të moshuarit.
4. Rezultatet për t'u arritur	P.sh. Personat e moshuar përdorin teknologjinë e informacionit më shpesh për të marrë informacion mbi shërbimet, për të marrë pjesë në komunitet dhe për të ndihmuar bashkëmoshatarët e tyre të fitojnë njohuritë dhe aftësitë e nevojshme për ta bërë këtë vetë; Përmbajtja dixhitale e shërbimeve dhe institucioneve vendore është më e aksesueshme për të moshuarit.
5. Maksimumi i buxhetit	5.700 Euro

1. Tema aktivitetit	Seminare edukative për personat me aftësi ndryshe
---------------------	---






Co-funded by
the European
Union



6. Periudha e zbatimit	Tetor 2022-Korrik 2023
7. Përshkrimi i aktivitetit	Psh. Organizimi i seminareve sistematike për personat me aftësi ndryshe lidhur me një sërë çështjesh që lehtësojnë pjesëmarrjen sociale. Seminarët do të përdorin përvojën e disa profesionistëve të fushave të ndryshme për të mësuar aftësi të ndryshme (si të shkruajmë në mënyrë kreative, pikturojmë, punojmë me argjile, të gatujmë etj). Do të përdoren gjithashtu edhe persona me aftësi ndryshe që janë trajnuar ndërkohë në një nga fushat e mësipërme. Njohuritë e përfuara nga seminarët do të mund të përdoret për të filluar aktiviteve të vogla fitimprurëse ose jo fitimprurëse (personat me aftësi ndryshe organizojnë ekspozita etj ku paraqesin apo shesin punët e tyre).
8. Rezultatet për t'u arritur	Psh. Personat me aftësi ndryshe mësojnë njohuri dhe aftësi të reja, janë më aktivë dhe përfshihen në jetën sociale të komunitetit
9. Maksimumi i buxhetit	5.700 Euro


1. 1. Tema aktivitetit	Fushata ndërgjegjësuese në nivel lokal
2. Periudha e zbatimit	Tetor 2022-Korrik 2023
3. Përshkrimi i aktivitetit	P.sh Organizimi i një fushate ndërgjegjësimi në nivel lokal që përbëhet nga prodhimi i materialeve të printuara, paraqitjet në media, aktivitete publike (diskutimet në panel, fokusimi në data të caktuara, ekspozitat, shfaqjet skenike, etj) me qëllim informimin e publikut për një çështje të veçantë dhe të rëndësishme për të moshuarit/personat me aftësi ndryshe dhe ndryshimi i perceptimit të personave të moshuar/personave me aftësi ndryshe.
4. Rezultatet për t'u arritur	P.sh. Materiale dhe qasje të zhvilluara me cilësi të lartë dhe aktivitete ndërgjegjësuese të zbatuara që nxjerrin në pah arritjet dhe kapacitetet e të moshuarve/personave me aftësi ndryshe dhe/ose problemet dhe nevojat e të moshuarve/personave me aftësi ndryshe në lidhje me përfshirjen dhe pjesëmarrjen sociale.
5. Maksimumi i buxhetit	5700 Euro

1. Tema aktivitetit	Përmirësimi i transportit në komunitetin lokal për të moshuarit/personat me aftësi ndryshe
---------------------	--






Co-funded by
the European
Union



2. Periudha e zbatimit	Tetor 2022-Korrik 2023
3. Përshkrimi i aktivitetit	P.sh. Vlerësimi i kapaciteteve të komunitetit për të ofruar mundësi transporti pa pagesë për të moshuarit/personat me aftësi ndryshe që do t'i ndihmojnë ata të lëvizin më lirshëm në komunitet. Opsionet e transportit do të mbështeten në kapacitetet personale të anëtarëve të komunitetit, të cilët do ta vënë kohën dhe automjetet e tyre në dispozicion për të moshuarit/personat me aftësi ndryshe.
4. Rezultatet për t'u arritur	P.sh. personat e moshuar/ personat me aftësi ndryshe janë në gjendje të lëvizin më lirshëm në komunitet, të bëjnë takimet e nevojshme (p.sh. për teste shëndetësore ose mbledhje sociale) dhe të marrin pjesë në aktivitete publike.
5. Maksimumi i buxhetit	5.700 Euro


1. Tema aktivitetit	Ofrimi i mbështetjes së strukturuar për kujdestarët informalë
2. Periudha e zbatimit	Tetor 2022-Korrik 2023
3. Përshkrimi i aktivitetit	P.sh. Seminaret e strukturuar dhe të rregullta për kujdestarët informalë do të përmirësojnë qëndrueshmërinë dhe aftësitë e tyre psikologjike dhe do t'i ndihmojnë ata të mbështesin personat e moshuar/personat me aftësi ndryshe të cilëve u ofrojnë kujdes në mënyra më efektive, duke rritur pavarësinë dhe kënaqësinë e tyre me kujdesin që marrin.
4. Rezultatet për t'u arritur	P.sh. Personave të moshuar/personave me aftësi ndryshe u ofrohen shërbime më cilësore, më të rregullta nga kujdestarët informalë, që plotësojnë nevojat e tyre dhe rrisin pavarësinë e tyre.
5. Maksimumi i buxhetit	5.700 Euro

1. Tema aktivitetit	Bizneset lokale mbështesin përfshirjen sociale të të moshuarve/personave me aftësi ndryshe
2. Periudha e zbatimit	Tetor 2022-Korrik 2023





Co-funded by
the European
Union



3. Përshkrimi i aktivitetit	P.sh. Bashkimi i një numri biznesesh lokale për të ofruar shërbim të veçantë për të moshuarit/personat me aftësi ndryshe p.sh. duke ofruar “çmim të mirë/këndshëm” të veçantë për një kafe/çaj në orare të caktuara të ditës për të moshuarit/personat me aftësi ndryshe, duke reklamuar këtë shërbim.
4. Rezultatet për t’u arritur	P.sh. Të moshuarit/personat me aftësi ndryshe rrisin pjesëmarrjen e tyre në jetën sociale të komunitetit nëpërmjet heqjes së disa pengesave për pjesëmarrjen e tyre dhe reklamimin e shërbimeve të përshtatshme për moshën dhe aftësitë.
5. Maksimumi i buxhetit	5700 Euro

1. Tema aktivitetit	Ushtrime fizike të përshtatshme për punë në grup për të moshuarit/personat me aftësi ndryshe
2. Periudha e zbatimit	Tetor 2022-Korrik 2023
3. Përshkrimi i aktivitetit	P.sh. Ushtrime të lehta, të strukturuar në grup për të moshuarit/personat me aftësi ndryshe në ambiente të jashtme dhe të brendshme të organizuara në intervale të rregullta në mënyrë që të promovojnë jo vetëm ushtrimet fizike, por edhe aktivitetin e përbashkët dhe shpirtin e grupit. Mund të përfshihen të rinj dhe në këtë mënyrë të lehtësohet solidaritetin midis brezave, si dhe personat e moshuar/personat me aftësi ndryshe që advokojnë për më shumë hapësira publike, të jashtme të pajisura dhe të përcaktuara në mënyrë adekuate për ushtrime.
4. Rezultatet për t’u arritur	P.sh. Personat e moshuar/ personat me aftësi ndryshe janë në gjendje më të mirë fizike dhe kanë zhvilluar rutina të shëndetshme me bashkëmoshatarët e tyre, kanë ndërtuar shpirtin e grupit dhe janë të lidhur më mirë me brezat e rinj nëpërmjet ushtrimeve të përbashkëta.
5. Maksimumi i buxhetit	5700 Euro

11. Aneksat

- Aneksi A: Formulari i aplikimit
Aneksi B: Buxheti
Aneksi F: Ftesë për tender

